



**INFORMACION
PËR GJYOTARËT
E SEKSIONEVE
CIVILE**

PJESËMARRJA E PSIKOLOGUT EKSPERT NË PROCESIN CIVIL ME TË MITUR



unicef 
for every child

Kuadri Ligjor

Angazhimi i psikologut në çështjet civile dhe administrative, në të cilat kërkohet shpërblimi i dëmit jomaterial për të miturit, bazohet në nenin 158/c të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 224/a të po këtij Kodi.

“Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë. Ekspertët zgjidhen nga një regjistër elektronik i personave të licencuar, i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë, përveç kur janë kushtet e parashikuara në nenin 224/d, pika 2, të këtij Kodi. Ekspertët caktohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.”

Çështjet e padive të dëmit në rastet e të miturve

Konteksti i çështjeve të dëmeve personale (fizike dhe psikologjike)

Paditë e lidhura me dëmin personal përbëjnë çështje civile në të cilat pala paditëse (zakonisht një individ) kërkon kompensim nga pala e paditur (zakonisht një individ, kompani ose institucion) për një dëm të pësuar nga veprimet e qëllimta ose të kryera nga pakujdesia e palës së paditur. Ky proces synon të mundësojë shpërblimin e individit të dëmtuar nga veprimet e palës së paditur. Sistemit të drejtësisë në këto raste i kërkohet:

- Të përcaktojë nëse pala e paditur ka patur detyrime/përgjegjësi të çdo lloji ndaj palës paditëse dhe nuk i ka përmbushur ato;
- Të përcaktojë nëse pala paditëse është dëmtuar nga mospërmbushja e detyrimeve/përgjegjësi të palës së paditur;
- Të përcaktojë nëse pala e paditur mund ta kishte parashikuar dhe parandaluar dëmin e shkaktuar ndaj palës paditëse;
- Të përcaktojë nëse pala e paditur ka detyrim t’i ofrojë palës paditëse një dëmshpërblim të çdo lloji.

Paditë e lidhura me dëmin personal përbëjnë çështje civile në të cilat psikologët përfshihen në mënyra të ndryshme. Një padi në lidhje me dëmin fizik dhe psikologjik që i shkaktohet një fëmije dhe që vjen si pasojë e sjelljeve me dashje ose të pakujdesshme të dikujt, nxit nevojën e mbledhjes së fakteve që do ta mbështesin ose rrëzojnë padinë.

Kontributi kryesor i psikologut në këto procese gjyqësore konsiston në ofrimin e opinioneve në lidhje me natyrën, shkaqet dhe pasojat e dëmit fizik dhe psikologjik.



Ky ekzaminim mundësohet me kërkesë të paditësit dhe karakterizohet nga:

1. Mbledhja e të dhënave nga burime dhe metodat të shumfishta të mbledhjes së tyre;
2. Përdorimi i instrumenteve të besueshme dhe të vlefshme për kontekstin e vlerësimit;
3. Respektimi i kufizimeve të ekspertizës psikologjike.

Rëndësia e çështjeve të dëmeve fizike ose psikologjike varet nga një sërë faktorësh, pasi çdo padi përbën një proces unik, i cili vlerësohet në varësi të kontekstit dhe rrethanave përkatëse.

Këta faktorë konsistojnë në:

- Natyrën dhe ashpërsinë e dëmit të ndodhur dhe përmirësimin, rehabilitimin a rekuperimin e pritshëm të tij;
- Sasinë e humbjeve që pasojnë dëmin, si p.sh.: trajtimi mjekësor ose psikologjik dhe kostot respektive të rehabilitimit;
- Faktorët demografikë si gjinia, moshë, statusi i punësimit të paditësit, etj.

Fokusi i ekspertizës psikologjike në çështjet e dëmit për të miturit

Për të përcaktuar nëse pala paditëse (i mituri) është dëmtuar psikologjikisht nga dëmi i përjetuar, psikologut ligjor mund t'i nevojitet:

- Të eksplorojë funksionimin psikologjik të paditësit përgjatë tre periudhave kohore: para, gjatë dhe menjëherë pas ndodhjes së dëmit të paditur;
- Të parashikojë funksionimin psikologjik të pritsëm të paditësit në të ardhmen;
- Të përcaktojë nëse paditësi duhet t'i nënshtrohet ndonjë trajtimi të shëndetit mendor në mënyrë që të rehabilitohet nga dëmi dhe nëse po, të përcaktojë llojin, kohëzgjatjen dhe frekuencën e trajtimit.

Duke qenë se shumë faktorë të tjerë mund të ndikojnë në funksionimin psikologjik të fëmijës është e rëndësishme të theksohet se ekspertiza psikologjike përbën vetëm një element mbështetës në identifikimin e simptomave psikologjike të të dëmtuarit, por e ka të vështirë të përcaktojë ose faktojë binomin shkak (ngjarja dëmtuese)-pasojë (dëmi psikologjik).

Çështjet e dëmeve personale në rastet e të miturve

Individët nën 18 vjeç përcaktohen në ligj si të mitur ose fëmijë. Një i mitur nuk mund të bëjë një padi në zotësinë e tij juridike, por përfaqësohet nga “një person i afërt”, zakonisht një prind, një kujdestar ligjor ose një pjesëtar i afërt i familjes. Paditë për dëmet personale të fëmijëve bëhen pas një vuajtjeje a dëmtimi fizik dhe/ose psikologjik që një i mitur përjeton.

Paditë e dëmeve në rastet e të miturve trajtohen ndryshe nga paditë e dëmeve në rastet e të rriturve. Te fëmijët, sa më shumë kohë të kalojë nga ndodhja e dëmit, aq më e vështirë bëhet për ta vërtetuar atë para Gjykatës.

Kategoritë tipike të çështjeve të dëmeve në rastet e të miturve

Të miturit të cilët përjetojnë një nga dëmet e mëposhtme mund të përjetojnë përveç vuajtjeve fizike edhe stres emocional, simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik (ÇSPT) dhe çrregullimeve të tjera psikologjike, ose madje të diagnostikohen me ÇSPT dhe çrregullime të tjera psikologjike:

- Dëmtime të fëmijëve me lodrat;
- Aksidente në shkollë/çerdhe/kopsht;
- Aksidente në këndin e lojërave;
- Akuza për dëmtime në lindje;
- Aksidente të fëmijëve në vende publike;
- Aksidente të rënda në të cilat fëmija dëmtohet fizikisht;



- Humbja/vdekja e prindërve në një ngjarje për të cilën është përgjegjëse pala paditëse;
- Abuzimi emocional, fizik, seksual nga një i rritur tjetër (i afërm, mësues, i huaj, etj).

Fushat e sugjeruara që duhen vlerësuar në rastet e dëmit psikologjik, i cili mund të shoqërohet me ÇSPT ose çrregullime të tjera psikologjike:

- Funksionimi para, gjatë dhe pas ndodhjes së ngjarjes;
- Ekspozimi ndaj ngjarjes (traumatike ose jo-traumatike);
- Mbështetja sociale;
- Komorbiditeti i simptomave psikologjike;
- Mundësia për veprime fiktive apo të simuluar me qëllim nxjerrjen e përfitimeve nga padia.

Ndërsa pyetjet standarde për t'u bërë në çështje me pretendime për shkaktim dëmi që ka sjellë çrregullime të ndryshme psikologjike, mund të ishin: A është faktori stresant aq traumatik sa dyshohet të ketë shkaktuar simptoma të ÇSPT ose probleme të tjera psikologjike të një ashpërsie të tillë për të sjellë si pasojë këto probleme? A po bazohet vlerësimi i problemeve psikologjike vetëm në raportimin subjektiv të fëmijës dhe përfaqësuesve të tij? Cili është niveli aktual i dëmtimit psikologjik të funksionimit të fëmijës?

Ekspertiza psikologjike

Psikologët që kryejnë vlerësime në çështjet e dëmit ku përfshihen të mitur, duhet të kenë kompetencë në fushat e mëposhtme:

1. Kërkim, teori, politika dhe praktikë lidhur me dëmet personale (fizike dhe psikologjike);
2. Ekspertizë në vlerësimin psikologjik të të miturve (në intervistimin, ekzaminimin dhe testimin psikologjik);
3. Psikologji zhvillimi, Psikologji e familjes, Psikopatologji e të miturve;
4. Efektet psikologjike të dëmeve personale dhe mënyrat e rehabilitimit të tyre;
5. Aspekte me rëndësi në sistemin ligjor dhe në psikologjisë ligjore;
6. Kodin Etik të Psikologut.

Sa më sipër mund ta ndihmojnë gjykatën të bëjë përzgjedhjen më të përshtatshme nga lista e përgjithshme, e vënë në dispozicion nga Urdhri i Psikologut.

Roli i psikologut si ekspert në çështjet e dëmit ku përfshihen të mitur

Roli i psikologut vlerësues në rastet e dëmeve personale ku përfshihen të mitur konsiston në realizimin e një procesi me 3 faza të nevojshme për përfundimin e një vlerësimi psikologjik profesional. Këto faza konsistojnë përkatësisht në:

1. Realizimin e procedurave paraprake të vlerësimit psikologjik, i cili përfshin:
 - Qartësimin e pyetjeve referuese me gjykatën, të cilat duhet të jenë në përputhje me rastin dhe ekspertizën e psikologut vlerësues;
 - Autorizimet e lëshuara nga gjykata për ekspertin, për të mundësuar marrjen e informacionit të vlerësimit psikologjik nga burimet e ndryshme të informacionit;
 - Marrjen e miratimit të informuar për të marrë pjesë në procedurat e vlerësimit nga i mituri dhe përfaqësuesi i tij, si dhe nga të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në vlerësim.
 - Në rastet kur shërbimi ka një tarifë për ekspertin, psikologu diskuton me prindin e fëmijës dhe avokatin e tyre lidhur me tarifat. Këto tarifa: a) duhet të jenë në përputhje me ligjin; b) të mos jenë abuzive dhe të mos paraqiten në faturë ndryshe nga sa janë bërë në realitet; c) nëse kufizimet e shërbimit mund të paraprihen për shkak të kufizimeve financiare, kjo diskutohet sa më parë me marrësin e shërbimit.

2. Ndjekja me rigorozitet e metodologjisë së procesit të vlerësimit psikologjik. Vlerësimi psikologjik në çështjet e dëmeve ku janë të përfshirë të miturit konsiston në aplikimin e metodave/technikave profesionale të vlerësimit psikologjik:

- Intervistimi klinik dhe ekzaminimi i gjendjes mendore të të miturit;
- Testimi psikologjik;
- Vëzhgimi i sjelljes;
- Intervistimi i burimeve dytësore (palëve të treta) - marrja e informacionit prej të cilëve duhet të mundësohet nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga gjykata;
- Shqyrtimi i dokumentacioneve të lidhura me rastin specifik.

3. Raportimi me shkrim i procesit të vlerësimit dhe komunikimi i informacionit të raportit të të gjitha palët e përfshira në proces.

Formati dhe përmbajtja e raportit të vlerësimit

Raporti i vlerësimit psikologjik me shkrim duhet t'i sigurojë gjykatës informacionin e nevojshëm për çështjen në vlerësim. Gjuha e raportit duhet të jetë e thjeshtë



dhe e kuptueshme jo vetëm nga personat që nuk kanë përgatitje në fushën e psikologjisë, por edhe nga vetë fëmija. Psikologu duhet të përdorë referenca për të mbështetur interpretimet dhe konkluzionet duke treguar se si janë arritur ato nga procesi i vlerësimit.

Formati i raportit të vlerësimit psikologjik në çështjet e dëmit ku janë të përfshirë të miturit duhet të përmbajë:

- Të dhënat demografike të rastit;
- Specifikime të vlerësuesit dhe vlerësimit (kredencialet e ekzaminuesit, kohëzgjatjen dhe frekuencën e procedurave dhe metodologjisë së vlerësimit);
- Pyetjet referuese, kush e kërkoi vlerësimin dhe arsyen e kryerjes së vlerësimit;
- Procedurat dhe kufizimet e vlerësimit;
- Metodologjinë-përshkrimin e të gjitha metodave/teknikave të vlerësimit të përdorura:
 - Historia jetësore (informacion i detajuar i marrë nga intervista klinike dhe ekzaminimi i statusit mendor);
 - Vëzhgimi i sjelljes;
 - Rezultatet e testeve (duke respektuar kriteret për aplikimin dhe përdorshmërinë e tyre në rastin dhe kontekstin aktual dhe duke përmendur kufizimet e përdorimit të tyre);
 - Dokumentacioni i dosjes dhe dokumentacionet shtesë të shqyrtuara;
 - Burimet dytësore ose palët e treta nga të cilat është marrë informacion në lidhje me çështjen;
- Përshtypje dhe interpretime;
- Përfundime dhe rekomandime.

Çështje të tjera civile ku kërkohet prania dhe ekspertiza e psikologut

Ekspertiza e psikologut mund të kërkohet nga Gjykata edhe në çështje të tjera ku të miturit nuk janë të përfshirë. Çështje të tilla mund të jenë:

- Çështjet me objekt shpërblim dëmi me paditës individë në moshë të rritur, ku gjejnë aplikueshmëri një pjesë e seksioneve më sipër.
- Heqja e zotësisë për të vepruar, ku nga psikologu kërkohet gjithashtu vlerësimi lidhur me përshtatshmërinë dhe marrëdhëniet midis kujdestarit potencial dhe personit të cilit kërkohet t'i hiqet zotësia për të vepruar.

KUJDES!

Psikologët, të cilët mund të thirren në cilësinë e ekspertit në këto çështje, duhet të jenë të përfshirë në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve, të publikuar nga Ministria e Drejtësisë. Rekomandohet që për çështjen e dëmeve jopasurore ku përfshihen të mitur, nga ky regjistër të përzgjidhen ata psikologë që janë trajnuar posaçërisht në fushën e drejtësisë për të mitur, lista e të cilëve i është dërguar zyrtarisht institucionit tuaj nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Psikologët e trajnuar janë pajisur me çertifikatë dhe kartë identifikimi të posaçme. Nëse në qarkun tuaj nuk ka psikologë që plotësojnë këto kritere, atëherë në këtë funksion mund thërrisni një psikolog nga qarku më i afërt.



Për të kontaktuar me Urdhrin e Psikologut:

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Ndërtesa 26,
Kati 2, Ap.9, Tiranë (pranë E88)

Email: info@urdhriipsikologut.al

sekretaria@urdhriipsikologut.al

presidenti@urdhriipsikologut.al

Web: www.urdhriipsikologut.al